



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 05, dt. 15.03.2024

MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS, TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË PËR VITIN 2024

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 97, datë 07.12.2023 “Për Buxhetin e Vitit 2024”, Ligjin Nr.8095, datë 21.03.1996 “Për Shërbimin Civil” i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM-së nr. 625, datë 28.09.2022, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Struktura aktuale bashkë me ndryshimet do të pasqyrohet edhe në Rregulloren e re për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Korçë. Me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Strukturën organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2024 sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Efektet financiare do të përballohen nga fondi i pagave, i miratuar për vitin 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Erjon Nexhipi

Konceptoi: R. Latollari
Konfirmoi: Gj. Kristo
Pranoi: Sek. K.Q.K. B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS, TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË PËR VITIN 2024

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2024”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjin Nr.8095, datë 21.03.1996 “Për Shërbimin Civil” i ndryshuar, VKM-së nr. 625, datë 28.09.2022, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, struktura organizative do të jetë si më poshtë:

I.

1. **Kryetari i Këshillit të Qarkut;** mban pozicionin si funksionar i zgjedhur. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është bazuar në lidhjen nr. 1, pika “e”, përcaktuar sipas VKM nr. 328, datë 31.05.2023
2. **Zëvendëskryetari i Këshillit të Qarkut;** mban pozicionin si funksionar i zgjedhur. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është bazuar në lidhjen nr. 1, pika “e”, përcaktuar sipas VKM nr. 328, datë 31.05.2023
3. **Sekretari i Këshillit të Qarkut;** mban pozicionin si funksionar i emëruar nga Këshilli i Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “6”, shkonja “c” dhe konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “I”, Kategoria “I-b”, grup diplome “1”

II. Kabineti i Kryetarit

Kabineti i kryetarit, si strukturë ndihmëse e përbërë nga funksionarë të emëruar, të cilët ushtrojnë veprimtari të drejtpërdrejtë ndihmëse për realizimin e funksioneve politike sipas

parashikimeve të nenit 13, të Ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996 “Për Shërbimin Civil” i ndryshuar si më poshtë:

1. **Drejtor i Kabinetit të kryetarit dhe këshilltar juridik;** mban pozicionin si funksionar i emëruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “6”, shkonja “c” dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “I”, Kategoria “I-b”, grup diplome “1”.
2. **Këshilltar për Teknologjinë dhe Komunikimin;** mban pozicionin si funksionar i emëruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “6”, shkonja “ç” dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “II”, Kategoria “II-b”, grup diplome “1”.
3. **Këshilltar për Projektet e Bashkimit Europian;** mban pozicionin si funksionar i emëruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “6”, shkonja “ç” dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “II”, Kategoria “II-b”, grup diplome “1”.

III. Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit.

Në përbërjen e këtij sektori do të jenë gjashtë nëpunës civilë sipas Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar:

1. **Përgjegjes i Sektorit të Financës dhe Buxhetit;** mban pozicionin si nëpunës civil. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “8”, dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “III”, Kategoria “III-a”, grup diplome “1”.
2. **Specialist për Shërbimet, Burimet Njerëzore dhe Emergjencat Civile;** mban pozicionin si nëpunës civil. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “8”, dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “III”, Kategoria “III-b”, grup diplome “1 ose 2”.
3. **Specialist për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Territorit;** mban pozicionin si nëpunës civil. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “8”, dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “III”, Kategoria “III-b”, grup diplome “1 ose 2”.
4. **Specialist për programet e zhvillimit;** mban pozicionin si nëpunës civil. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “8”, dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “III”, Kategoria “III-b”, grup diplome “1 ose 2”.
5. **Specialist për Shëndetsinë dhe Çështjet sociale, arsimin dhe Kulturën;** mban pozicionin si nëpunës civil. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “8”, dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “III”, Kategoria “III-b”, grup diplome “1 ose 2”.
6. **Specialist i arkiv/protokollit.** Pozicioni i propozuar bazuar në nevojat e instiucionit dhe dispozitave ligjore në fuqi. Është punonjës me status civil me kategoninë nëpunës ekzekutiv. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “8”, dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328,

datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “III”, Kategoria “III-b”, grup diplome “1 ose 2”.

IV. Punonjës administrative.

1. **Shofer autoveture i institucionit;** mban pozicionin si punonjës administrativ. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “11”, të VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023

i propozojmë Këshillit të Qarkut Korçë, miratimin e Strukturës organizative Këshillit të Qarkut, si dhe konfirmimin e nivelit të pagave për vitin 2024.

Pozicionet e sipërcituara do të specifikohen me përshkrimet përkatëse të pozicioneve të punës, të cilat do të pasqyrohen me ndryshimet në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Korçë, të miratuar me vendimin nr. 3, datë 30.03.2020, e cila do të përditësohet sipas strukturës aktuale për vitin 2024.

Niveli i pagave do të pësojë ndryshime për pozicionin specialist i arkiv/protokollit, bazar në VKM nr. 328, datë 31,05,2024. Nivelet e tjera nuk kanë pësuar ndryshime që nga miratimi në mbledhjen e muajit Qershor 2023.

Mbi bazën e këtyre niveleve është llogaritur edhe fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore, të cila janë parashikuar në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2024.

Sa më sipër paraqesim për miratim strukturën organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar si dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2024 sipas tabelës bashkëngjitur.

Korçë, më 12.03.2024

**ZYRA E SHËRBIMEVE,
BURIMEVE NJERËZORE
DHE EMERGJENCIVE CIVILE**

Redir: Latollari



STRUKTURA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATËS TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2024

V.K.M. nr. 328, dt. 31.05.2023 Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore

Nr.	Njësia strukturore	Nr. Punonjësve	Kategoria	Grupi i diplomës	Shtesa e nivelit të kualifikimit	Vjetërsi	Paga e pozicionit	Statusi i punonjesit
I	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja 1/e				170000	Të zgjedhur
II	Zvendëskryetar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja 1/e				125000	Të zgjedhur
III	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja 8, I-b	1	14000	2%	100500	Të emëruar nga Këshilli i Qarkut
IV	<i>Kabineti i Kryetarit</i>							
	Drejtor i kabinetit të kryetarit - Këshilltar juridik	1	Lidhja 8, I-b	1	14000	2%	112500	Pozicion pune i emëruar nga Kryetari mbështur në nenin 13, të Ligjit nr 8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar.
	Këshilltar për Teknologjinë dhe Komunikimin	1	Lidhja 8, II-b	1	14000	2%	85000	Pozicion pune i emëruar nga Kryetari mbështur në nenin 13, të Ligjit nr.8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar.
	Këshilltar për Projektet e Bashkimit European	1	Lidhja 8, II-b	1	14000	2%	91000	Pozicion pune i emëruar nga Kryetari mbështur në nenin 13, të Ligjit nr.8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar.
V	<i>Spektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit</i>							
	Përgjegjes i Sektorit të Financës dhe Buxhetit	1	Lidhja 8, III-a/1	1	14000	2%	80300	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për Shërbimet, Burimet Njerëzore dhe Emergjencat Civile	1	Lidhja 8, III-b	1 ose 2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Teritorit	1	Lidhja 8, III-b	1 ose 2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për programet e zhvillimit	1	Lidhja 8, III-b	1 ose 2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për Shëndetsinë dhe Çështjet sociale, arsimin dhe Kulturën	1	Lidhja 8, III-b	1 ose 2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për arkiv/protokoll	1	Lidhja 8, III-b	1 ose 2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
VI	<i>Punonjës administrativë</i>							
	Shofer autoveture i institucionit	1	Pika 11 dhe 12			1%	47000	Pozicion pune me kontratë
	Totali Administrata	13						

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

